



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR POGRADEC

Nr. ____ Prot.

Pogradec me 12 Dhjetor 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Oksigjen Mjekësor i Gazte për nevoja të Drejtorise te Sherbimit Spitalor Pogradec”-Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Oksigjen – 24111900-4.

VLERA FONDI LIMT /VLERA E PRITSHME E KONTRATËS ESHTË: 4,976,640 leke(Kater milion e nenteqind e shtatedhjet e gjashte mije e gjashteqind e dyzet) pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt: **Blerje Oksigjen Mjekësor i Gazte për nevoja të Drejtorise te Sherbimit Spitalor Pogradec**”-Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 24 muaj me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26,29,30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqese:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes/ Kualifikimit pika 1 e shtojces 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, nenin 82, të LPP, nenin 46, dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operoret ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per tre vitet e fundit financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros minimale per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jetë jo më e vogël se 40% e vleres së përlloritur të fondit **limit / vlera e priteshme e kontratatve per te cilet oferton. Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese operatori ekonomik arrin vleren e xhiron minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e ligjit, nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" te ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/c dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/c

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlloritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratatve që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratatve specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së perlllogaritur të fondit *per te cilat oferton*. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësor. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4, të nenit 40, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, në të cilin është e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e

objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar edhe në nenin 55 “Proçedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të VKM-se me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se:4) Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim te bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për tregtim me shumice te barnave të lëshuar nga QKL ose QKB, **OSE** të disponojnë katëgori/nënkategori të prodhimit dhe/ose tregtimi të barnave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik” te ndryshuar, nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, ligji nr.10081, datë 23.2.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë vendin e prodhimit te mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 3 të DST_Lista e cmimeve te artikujve)

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

/ose/

- autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Ligjin 105/2014 “Per barnat dhe shërbimin farmaceutik”, VKM-ne nr. 299, datë 08.04.2015 “Për Miratimin e rregullores për dhënie e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Ligji për barnat dhe pajisjet mjekësore në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, vendos që barnat duhet të jenë të siguruara dhe të kalojnë procedurat e rregullta të kontrollit përpara se të vendosen në treg. Kjo garanci jepet përmes autorizimit nga AKBPM, i cili verifikon se produkti farmaceutik përmbush standardet e nevojshme të cilësisë, sigurisë dhe efektivitetit për përdoruesit. Dokumenti që vërteton autorizimin për tregtim është një dëshmi e ligjshmërisë së ofrimit të barit në tregun shqiptar. Pa këtë dokument, një bar nuk mund të tregtohet në mënyrë të ligjshme në Shqipëri. Kriteri kërkon që operatori ekonomik të sigurojë një dokument për këtë autorizim, duke u siguruar që bari/rat e ofertuar janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kërkesa që autorizimi të jetë brenda afatit të vlefshmërisë ka për qëllim të shmangë përdorimin e barnave që mund të kenë kaluar periudhën e tyre të certifikimit dhe të mos përmbushin më standardet e përcaktuara për sigurinë dhe efektivitetin. Për rrjedhojë, kjo kërkesë ndihmon në parandalimin e situatave ku mund të përdoren barna të papërshtatshme për konsum njerëzor.

Në përfundim, ky kriter synon të garantojë që barnat e ofertuar janë të ligjshme, të sigurta dhe të certifikuar për përdorim në përputhje me legjislacionin shqiptar për barnat dhe pajisjet mjekësore, dhe përmbushin standardet e cilësisë së përcaktuara nga autoritetet përkatëse.

- 2.3.5** Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2026), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ”Ligjin 105/2014” Per barnat dhe shërbimin farmaceutik”, VKM-ne nr. 299, datë 08.04.2015 “Për Miratimin e rregullores për dhënie e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Certifikate ISO 9001:2015 "Per Sistemin e menaxhimit te cilesise" ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për fushën e aktivitetit të OE/ që perkon/ përputhet me objektin e Prokurimit. Certifikata kërkohet të jetë origjinale ose e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

2.3.7 Certifikate ISO 45001:2018 ,ose ekuivalent, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë . Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë origjinale ose e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

2.3.8 Certifikatë ISO 14001:2015—Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjeksore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë origjinale ose e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa për pikat e mësipërme 2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8 është përcaktuar bazuar në:

Nein 79, pika 1, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Nein 44, pika 1, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se:

1. Autoriteti/entikontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë furnizimin në mënyrë cilësore.

2.3.9. Transporti i bombolave të oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet të bëhet me automjete të pajisur me :

- Leje për transport gazra mjeksore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Leje për transport gazra mjeksore nën presion të lëshuar nga MNZSH.

- Certifikatë miratimi ADR të leshuar nga DPSHTRR.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162 date 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”te ndryshuar, dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

II. SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE GRAFIKU I LEVRIMIT

Specifikimi i Materialeve

Nr .	Sistemi	Emertimi Tregetar	Formedoza	Principi aktiv	Njesia	Sasia ne litra e planifikuar per 24 muaj
1	Anestezi renimacion	PURE OXYGEN MEDICAL GAS	Medicinal gas x100%	Oxygen	litra	144,000

1. Oksigjen i gazet

Oksigjen	O ₂	99,50 %
Monoksid karboni	CO	0.13 vmp (volum për milion)
Bioksid Karboni	CO ₂	0.11 vpm
Ujë	H ₂ O	0.06 vpm

Kushtet e furnizimit.

- Furnizimi me oksigjen mjeksor te gazte do behet me bombola 40 litra sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor me bombulat e operatorit ekonomik.
- Furnizimi i realizuar prane AK-se do te shoqerohet me flete analize
- Presioni i mbushjes së bombulave të jetë jo më pak se 125 bar.
- Ambalazhimi i oksigjenit për përdorim mjeksor të jetë në bombulat e OE
- Bombulat të kenë shenjën dalluese “ për përdorim spitalor” (O₂)
- Transportimi dhe shkarkimi i mallit eshte pergjegjesi e shitesit
- Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor për këtë artikull,
- bazuar në kontratat e lidhura gjate gjithë periudhës së vlefshmerisë së Marrveshjes Kuadër.
- Bombolat e oksigjenit duhet të shoqërohen me vërtetimin e kryerjes së kontrolleve periodike të **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatorë/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore. , ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.

Transporti i bombolave të oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet të bëhet me automjete të pajisur me :

- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
- Certifikatë miratimi ADR të leshuar nga DPSHTRR.

- Transportimi dhe shkarkimi i mallit është përgjegjesi e shitesit
- Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor për këtë artikull, bazuar në kontratat e lidhura gjate gjithë periudhës së vlefshmerisë së Marrveshjes Kuadër.
- AK-ja do të hartojë grafikët mujor të lëvrimit të mallit, një kopje e të cilit i jepet furnizuesit në fund të çdo muaji për muajin pasardhës. Në cdo rast duhet lajmëruar furnizuesi dy ditë më parë.
- Për arsye të krijimit të një sigurie në kryerjen e furnizimit pa krijuar vonesa dhe mbulimin në kohe dhe pa probleme të nevojave për oksigjen nisur dhe nga përvajtjet e meparshme, Autoriteti Kontraktor do të lidhe me operatorin ekonomik fitues të dalë nga procedura e prokurimit, kontratë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor.
- Furnizimi do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesave të D.SH.S. Pogradec. Njoftimet lidhur me kërkesat për furnizim, duhet të behen në adresën e emailit të OE të kontraktuar ose në numrin e telefonit që do të përcaktohet si pikë kontakti. Njoftimi duhet bere 2 dite pune para, pa përfshirë ditët e pushimit zyrtar por me kushtin që në rast emergjence OE duhet të furnizojë AK brenda 24 orëve nga njoftimi.
- Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.
- Oksigjeni i bombolave që do të përdoren duhet të jete i regjistruar në AKBPM për tregtim në Republikën e Shqipërisë.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara si më lart është realizuar në mënyrë të plotë, dhe të sakte duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP: ***“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë”*** si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ***“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.***

”Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”

.Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)